

VENDIM
Nr. 393, datë 7.5.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MBROJTJES, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
STRUKTURAVE TË ANGAZHUARA PËR PASTRIMIN E ZONAVE BREGDETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, të shtohet fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të strukturave të angazhuara për pastrimin e zonave bregdetare për sezonin turistik veror, për vitin 2015, në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të lidhin marrëveshje, në të cilën të përcaktohen zonat bregdetare që do të pastrohen, koha, mjetet dhe personeli i Forcave të Armatosura që do të vihet në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama